



VENDIM

Nr.124 Datë. 01.12.2014

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “CEREMI” DHE “DRAGOBIA”.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
(Mungon struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.
(mungon vertetimi për shlyerjen e tatim-taksave)
- Dokumentacionit teknik (Neni 9, pika 4.1.1 ;pika 4.1.2; 4.1.3;) janë plotësuar pjesërisht. (Jane pa plotësuar të dhënat teknike për hec-et, nga aplikuesi. Jane pa plotësuar të dhënat teknike për bllokun e transformimit, nga aplikuesi.)
- Dokumentacionit teknik Neni 9, pika 4.1.3 është plotësuar korrekt.
- Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik është plotësuar pjesërisht.
(mungon një studim i fizibilitetit, grafiku i zbatimit të projektit dhe plani i biznesit.)
- Leje nga institucione të tjera.(Neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar korrekt.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, të paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k për licensim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Ceremi” dhe “Dragobia” me fuqi të instaluar “Ceremi” 8.6 MW dhe “Dragobia” 13.4.Me fuqi totale 22 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për:

VENDIMIN

Nr.124 Datë. 01.12.2014

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “CEREMI” DHE “DRAGOBIA”.**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
